



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05

Prokurori kundër Salih Mustafës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 28 mars 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për Autorizim për t'u Dhënë
Informacion Ekspertëve Mjekësorë**

T'i njoftohet:

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtjes së të akuzuarit

Julius von Bone

Zyrës Administrative

Shefit të Zyrës për Mbrojtjen dhe
Mbështetjen e Dëshmitarëve

Mbrojtëses së viktimave

Ani Pues

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues) nxjerr këtë vendim lidhur me kërkesën e mbrojtëses së viktimave për autorizim për t'u dhënë informacion ekspertëve mjekësorë.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIME

1. Më 21 mars 2022, Trupi Gjykues caktoi *Instituut voor Mensenrechten en Medisch Onderzoek* (Instituti për Të Drejtat e Njeriut dhe Vlerësim Mjekësor - iMMO) për të bërë një vlerësim të gjendjes psikiatrike dhe një vlerësim mjekësor të dëmit fizik dhe psikologjik dhe lëndimeve të pësuar nga viktimat 08/05, 09/05 dhe 10/05, të shkaktuara nga tortura, trajtimi mizor dhe ndalimi arbitrar i pretenduar, dhe për të përgatitur aktekspertizën mjekësore përkatëse brenda 13 marsit 2022.¹

2. Më 23 mars 2022, Trupi Gjykues mori nga mbrojtësja e viktimave “Kërkesën për Autorizim për t'u Dhënë Informacion Ekspertëve Mjekësorë” (Kërkesa),² ku i kërkonte autorizim Trupit Gjykues për t'u dhënë ekspertëve mjekësorë që janë caktuar, të gjitha deklaratat e dhëna nga viktimat 08/05, 09/05 dhe 10/05 gjatë hetimit, si dhe transkriptet e deklaratave të tyre para këtij Trupi Gjykues, të dhëna në seanca publike ose private.³

3. Më 24 mars 2022, Trupi Gjykues shkurtoi afatet për dorëzimin e përgjigjeve të përcaktuara në rregullën 76 Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) për dorëzimin e parashtrimeve dhe urdhëroi Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dhe Mbrojtjen që, nëse dëshirojnë, t'i përgjigjen Kërkesës brenda 25 marsit 2022.⁴

4. ZPS-ja dhe Mbrojtja nuk dorëzuan përgjigje.

¹ KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 21 mars 2022, publik, f. 2533, rreshti 12 deri në f. 2534, rreshti 4.

² KSC-BC-2020-05, F00362, Mbrojtësja e viktimave, *Kërkesë e Mbrojtëses së Viktimave për Autorizim për t'u Dhënë Informacion Ekspertëve Mjekësorë*, 23 mars 2022, publike.

³ Kërkesa, para. 4.

⁴ Mesazh elektronik nga Trupi Gjykues për palët dhe mbrojtësen e viktimave përmes Njesisë për Administrimin e Gjykatës, 24 mars 2022, në orën 16:11.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Trupi Gjykses mbështetet në nenet 23(1) dhe 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullën 81 të Rregullores.

III. ANALIZË

6. Trupi Gjykses kujton se viktimat 08/05, 09/05 dhe 10/05 përfitojnë nga masat mbrojtëse në procedurat gjyqësore aktuale, për faktin se nxjerrja e identitetit të tyre dhe e çdo të dhëne identifikuese për publikun përbën rrezik objektivisht të arsyetueshëm për këto viktima.⁵

7. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses vlerëson se Kërkesa është në thelb mocion për ndryshimin e masave mbrojtëse sipas rregullës 81 të Rregullores.

8. Në pajtim me rregullën 81(5) të Rregullores, Trupi Gjykses, nëpërmjet Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve, sigurohet që personi i mbrojtur të ketë dhënë pëlqimin për ndryshimin e masave mbrojtëse. Trupi Gjykses gjykon se pëlqimi mund të kërkohet edhe nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të personit apo personave në fjalë, që në çështjen konkrete është mbrojtësja e viktimave, në pajtim me rregullën 114(1) të Rregullores.

9. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vëren se mbrojtësja e viktimave nuk ka dorëzuar zyrtarisht pëlqimin e viktimave 08/05, 09/05 dhe 10/05 për ndryshimin e masave mbrojtëse dhe as nuk ka njoftuar nëse ndonjë prej viktimave apo të gjitha, kanë hequr dorë, tërësisht apo pjesërisht, nga masat mbrojtëse në pajtim me rregullën 81(6) të Rregullores. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses i kujton mbrojtëses së viktimave të

⁵ KSC-BC-2020-05, F00105, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 30 prill 2021, konfidencial, para. 54(e)-(f). Versioni i redaktuar publik u dorëzua në po të njëjtën ditë, F00105/RED; F00126, Trupi Gjykses I, *Vendim i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 21 maj 2021, konfidencial, para. 42(d)-(e). Versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F00126/RED.

zbatojë procedurat e përcaktuara në rregullën 81 për çdo kërkesë të ardhshme të këtij lloji.

10. Sa i përket përmbajtjes së Kërkesës, Trupi Gjykses vlerëson se nuk ka asnjë rrezik për viktimat 08/05, 09/05 dhe 10/05, sepse nxjerrja e informacionit të kërkuar nga mbrojtësja e viktimave do të bëhet në kontekstin e një vlerësimi mjekësor profesional që do të kryhet nga një institut i pavarur dhe me përvojë, i cili do të veprojë në bazë të parimit të konfidencialitetit mes doktorit dhe pacientit si dhe të parimit “mos bëj dëm”.⁶

11. Pasi shqyrtoi sa më sipër, dhe në varësi të njoftimit paraprak nëpërmjet një parashtrimit të protokolluar, se mbrojtësja e viktimave mori pëlqimin e bazuar në informacion të viktimave 08/05, 09/05 dhe 10/05 për ndryshimin e masave mbrojtëse, Trupi Gjykses autorizon mbrojtësen e viktimave t’u japë ekspertëve mjekësorë të caktuar: (a) të gjitha deklaratat e dhëna nga viktimat 08/05, 09/05 dhe 10/05 dhe të nxjerra në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-05; dhe (b) transkriptet e deklaratave të tyre para Trupit Gjykses, të dhëna si në seanca publike dhe private/të mbyllura.

12. Gjithashtu, Trupi Gjykses i rikujton mbrojtëses së viktimave që të informojë ekspertët mjekësorë të caktuar se informacioni në fjalë është konfidencial dhe duhet të trajtohet si i tillë.

⁶ United Nations Office of the High Commissioner for Human Rights, [Istanbul Protocol: Manual on the effective investigation and documentation of torture and other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment](#), 9 August 1999, para. 57, 65.

IV. VENDIM

13. Për arsyet e përmendura më lart, Trupi Gjykues:

- a. **MIRATON** Kërkesën siç specifikohet në paragrafët 11-12 të këtij vendimi; dhe
- b. **UDHËZON** mbrojtësen e viktimave të informojë ekspertët mjekësorë të caktuar se informacioni në fjalë është konfidencial dhe duhet të trajtohet si i tillë.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E enjte, 28 mars 2022

Në Hagë, Holandë